



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 4, Datë 30.07.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetar |
| - Z. Bashkim Sykja | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2010, mori në shqyrtim deklarinin “Aprovuar nga Komuniteti Evropian” ne etiketimin e ujit Tepelena, nga operatori Uji Ftohte Tepelene sh.p.k.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes dhe degjimit te përfaqësuesve te Uji i Ftohtë Tepelenë sh.p.k,

VËREN SE:

Deklarimi “Aprovuar nga Komuniteti Evropian” ne etiketën e ujit “Tepelena”, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, Pjesa IV – Praktikrat e tregtimit, Kreu I – Praktikrat e padrejta tregtare:

- **neni 17/A pika 4**, sipas te cilit: “*Pretendimi se një tregtar (përfshirë edhe praktikrat e tij tregtare) ose një mall apo shërbim është miratuar ose autorizuar nga një organizëm publik apo privat kur nuk është e vërtetë, ose ngritja si një pretendim në mospërputhje me kushtet e miratimit apo autorizimit*”, përbën një praktike tregtare te padrejte, dhe
- **nenit 13, pika 5**, sipas te cilit “*praktikat e padrejta tregtare janë te gjitha te ndaluara*”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 13, pika 5; nenin 17/A, pika 4 si dhe nenin 55, të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/b të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

Uji i Ftohte Tepelena sh.p.k te marre masa per ndreqjen e shkeljes, duke hequr deklarimin "Aprovuar nga Komuniteti Evropian" ne etiketën e ujit Tepelena, te vendosur ne treg qe nga 1 Nëntori 2010 e ne vazhdim.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI